

Raporti Perfundimtar
Per
Vleresimin e punes se kryer ne
Sektorin e Studim Projektimit

Bashkia Devoll

I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbeshtetur ne ligjin nr. 114 date: 22/10/2015 "Per auditimin e brendshem ne sektorin publik", Manualit te auditit te brendshem te miratuar me urdherin nr.100 Date:25.10.2016 te Ministrit te Financave, urdherit te kryetarit te bashkise nr 97 date 12.04.2018 "Per ushtrimin e nje kontrolli tematik ne Sektorin e Studim Projektimit", njoftimin per fillimin e angazhimit te auditimit nr 1098 Prot, date 19.04.2018 "Mision auditimi Tematik ne **Sektorin e Studim Projektimit**",u krye gjate periudhes 19.04.2018-04.05.2018,per periudhen nga data 01.01.2017-10.04.2018.Auditimi u krye nga specialistet ne zyren e Auditimit te Brendshem Z.Eduard Shaholli dhe Z.Taulant Zhgaba.

Misoni i ketij auditimi eshte qe te ndihmoje **Sektorin e Studim Projektimit** ne realizimin e objektivave te veprimtarise duke permiresuar sistemet e kontrollit dhe performances. Nga auditimi i kryer ne **Sektorin e Studim Projektimit** eshte vleresuar ne teresi sistemi ne perputhje me udhezimet dhe metodikat me qellim qe sistemi i kontrollit te njesise te audituar te jene transparent dhe ne perputhje me normat e ligjshmerise, rregullshmerise, frytshmerise dhe kursimit.Jane realizuar te gjitha pikat e programit te pergatitura nga specialistet e auditit.

Qellimi i angazhimit te auditimit eshte vleresimi dhe dhenia e sigurise objektive,te pavarur mbi veprimtarine ne **Sektorin e Studim Projektimit** per te vleresuar efektivitetin dhe eficencen per arritjen e objektivave te menaxhimit financiar dhe kontrollit te brendshem dhe njekohesisht dhenia e rekomandimeve per permiresimin e sherbimit.

Sipas tematikes se percaktuar ne programin e auditimit analizuam dhe vleresuam veprimtarine e e **Sektorit te Studim Projektimit** per periudhen 01.01.2017 deri 10.04.2018,duke ekzaminuar ne vecanti te gjitha dokumentat ,proces verbalet,vendimet qe dispononte ky sektor dhe per nevoja qe mund te lindin gjate auditimit edhe dokumenta te vitit 2016.

Ne perfundim te auditimit ne **Sektorin e Studim Projektimit** jane kostatuar shkelje te akteve ligjore dhe nenligjore qe kane te bejne me.

-Mos perfshirjen ne paketen fiskale te tarifes se aplikimit per punimet me deklarate punimesh (duke sjelle mos arketimin e kesaj takse e cila ne vetvete eshe e ardhur e munguar ne buxhet sipas projektraportit).Nga verifikimet mbas observacionit arketime jane kryer por ne kundertshtim me ligjin sepse eshe mbledhur nje tarife e pa miratuar nga keshilli bashkiak.

-Kthimin e pergjigjeve per lejimin e punimeve qe kryhen pa paisjen me leje ndertimi duke mos vene ne dijeni Agjensine e Inspektimit te Teritorit ne shumicen e rasteve.Kjo gje ka sjelle mosrespektim te dispozitave te parashikuar nga kuadri ligjor ne fuqi per veprimtarite ndertimore dhe konkretisht mosrespektim te nenit 6 te vendimit nr 408 date 13.05.2015 “Per miratimin e regullores se zhvillimit te teritorit”.

-Ne sistemin e mosrespektimit te afateve te kthimit te pergjigjeve drejt institucioneve ligjzbatuese duke sjelle vonesa ne kordinimin e puneve ndermjet institucioneve.

-Ne sistemin e mosverifikimit dhe mbledhjes kryesisht te gjithe informacionit per nevoja te shqyrtimit dhe vendmarjes perkatese u kostatua se u ishte kthyer pergjigje personave te interesuar per punime te ndryshme (kryesisht atyre per punime pa leje ndertim)i pa mbledhur dokumentacion dhe informacion apo te dhena perkatese por eshte mjaftuar thjesht me kerkesen e bere nga personat e interesuar veprim ne kundertshtim me nenin 4 te vendimit nr 408 date 13.05.2015 “Per miratimin e regullores se zhvillimit te teritorit”.

-Ne sistemin e punes per hartimin e Planit te Pergjithshem vendor u kostatua se nuk ka asnje hap konkret apo gjurme te fillimit te punes ne lidhje me nismen per hartimin e Planit te Pergjithshem Vendor.

VI. Rekomandimet

Ne perfundim te procesit te vleresimeve te bera nga specialistet e auditimit per personat pergjegjes bazuar ne nenin 6 pika c e Ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” per aritjen e objektiveve te **Sektorit te Studim Projektimit ne Bashkine Devoll** si dhe per te ritur efektivitetin ne punen funksionimin dhe drejtimin e ketij sektori,**rekomandojme.**

1.Te meren masa qe cdo fillim viti pergjegjesi i Sektorit gjate hartimit te paketes fiskale dhe parashikimit te te ardhurave te respektoje ligjin duke future ne skemen e taksave dhe tarifave cdo takse dhe tarife qe lejon legjislacioni ne fuqi ne mynyre qe keto te ardhura te gjenerohen investime per komunitetin dhe te mos aplikohen tarifa te pa miratuar nga keshilli bashkiak.

*Personi pergjegjese:Pergjegjesi i Sektorit te Studim Projektimit
Juristi i Sektorit*

Afati:Ne vazhdim

2. Ne rastet e kthimit te pergjigjeve per lejimin e punimeve qe kryhen pa paisje me leje ndertimi te vihet gjithmone ne dijeni pa perjashtuar asnje rast Agjensia e Inspektimit te Teritorit dhe te meren masa verifikimi per vertetesine e kerkeses se bere nga qytetaret.

Personat pergjegjese: Sektori i Studim Projektimit

Afati: Menjehere

3. Ne kthimin e pergjigjeve dhe korespondencave zyrtare me institucionet e tjera ne asnje rast te mos neglizhohet kthimi i pergjigjeve dhe po ashtu i pergjigjeve te kthjera jashte afateve ligjore.

*Personi pergjegjese: Pergjegjesi i Sektorit te Studim Projektimit
Juristi i Sektorit*

Afati: Ne menjehere

4. Te meren masa qe te fillohet me hapa konkrete hartimi i Planit te Pergjithsem Vendor.

Personat pergjegjese: Sektori i Studim Projektimit

Afati: Menjehere

Auditi i Brendshem Bashkia Devoll